



Technical Secretariat of the
National Water Council

NDRYSHIMET LIGJORE NE SEKTORIN E UJIT

Ligj Nr. 111/2012

‘Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore’ *(i ndryshuar)*

VLORË 28 QERSHOR 2018

Kur ka hyrë në fuqi ligji dhe si ka ndryshuar?

A. Ligji nr.111/2012, datë 15.11.2012 është **Botuar në Fletoren Zyrtare nr.157, datë 6 Dhjetor 2012**

Ky ligj është përafruar plotësisht me:


Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 Tetor 2000, “*Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave*”. Numri CELEX: 32000L0060 , Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 327, datë 22.12.2000, faqe 1 – 73.

B. Ligji nr.6/2018, datë 8.2.2018 është **Botuar në Fletoren Zyrtare nr.30, datë 7 mars 2018**


Aksioni Kombëtar për Reformimin e Sektorit të Ujit

1. Aksioni për ndalimin e veprimtarisë në brigje
2. Aksioni për ujin e pijshëm
3. Aksioni për ndalimin e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore
4. Ndryshimi i përbërjes institucionale

Kush i merrte vendimet në sektorin e ujit?



Çfarë ndryshon ?



KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT (KKU)

1. Këshilli Kombëtar i Ujit është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore.
2. Këshilli Kombëtar i Ujit është organ ndërministror që kryesohet nga Kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

Çfarë është e re?


3§ ç) çdo autoritet kontraktor, përpara se të nisë një procedurë koncesioni për përdorimin e burimeve ujore, duhet të marrë miratimin, në parim, nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

3§ d) miraton rregulloren e Këshillit të Basenit Ujor.

4. *Aktet me karakter normativ të Këshillit Kombëtar të Ujit botohen në Fletoren Zyrtare.*

AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE (AMBU)

AMBU organizohet në nivel qendror dhe në nivel baseni ujqor nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujqore. AMBU është person juridik shtetëror, që financohet nga buxheti i shtetit



AMBUKA KËTO KOMPETENCA:

- a) **harton dhe zbaton politika, strategji, plane, programe dhe projekte**, që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ruajtjen sasimore dhe cilësore, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre;
- b) **zbaton dispozitat e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare** për burimet ujore dhe ato ndërkufitare, palë e të cilave është edhe Republika e Shqipërisë;
- c) ushtron funksionet e *Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit*;
- ç) i propozon Këshillit Kombëtar të Ujit dhënien me koncesion të burimeve ujore;
- d) i propozon Këshillit Kombëtar të Ujit dhënien e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit dhe shkarkimeve, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm;
- dh) **harton inventarin kombëtar të burimeve ujore**, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor;
- e) **harton dhe ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujore**;
- ë) **harton dhe ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit për ujërat ndërkufitare**;
- f) është përgjegjëse për veprimtarinë ekonomike të burimeve ujore;
- g) kërkon nga organet dhe institucionet shtetërore, agjencitë dhe entet publike informacion, të dhëna teknike, analiza apo mbështetje tekniko-konsultative që shërbejnë për nevojat e administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore;
- gj) nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e burimeve ujore;
- h) nxit studime e kërkime për zhvillimin e të rejave teknike që lidhen me përdorimin, zbulimin, shfrytëzimin, ruajtjen, trajtimin, mbrojtjen, administrimin dhe përdorimin efikas të burimeve ujore;
- i) në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore, përcakton fushat e kërkimit dhe të studimit për burimet ujore, si dhe fondet përkatëse për to;
- j) bashkërendon dhe kontrollon punën e organeve vendore të menaxhimit të burimeve ujore;
- k) **kundërshton në gjykatë vendimet e Këshillit të Basenit Ujor**

KËSHILLI I BASENIT UJOR (KKU)

Këshilli i basenit ujqor është organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujqore në basenin përkatës, në nivel vendor.

Këshilli i basenit ujqor ka këto detyra:

- a) siguron ruajtjen dhe zhvillimin sa më racional të burimeve ujqore brenda kufijve të basenit përkatës ujqor;
- b) siguron shpërndarjen e drejtë të burimeve ujqore brenda kufirit të basenit përkatës ujqor, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre;
- c) siguron mbrojtjen e burimeve ujqore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet që prekin cilësinë dhe sasinë e tyre;
- ç) identifikon trupat ujqorë përkatës që kanë nevojë për mbrojtje.

ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BASENEVE UJORE (ZABU)

Zyra e Administrimit të Basenit Ujor është struktura në varësi të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, e cila ngrihet dhe funksionon në çdo basen ujor.

Zyra e Administrimit të Basenit Ujor ka këto detyra:

- a) përpilon projektin e planit për burimet ujore për basenin përkatës dhe e paraqet për miratim në KBU;
- b) harton inventarin e burimeve ujore në sasi dhe cilësi, si dhe bën periodikisht përditësimin e tij;
- c) nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e burimeve ujore;
- ç) përgatit raporte, jep opinione për burimet ujore dhe i paraqet ato për ndjekje të mëtejshme në këshillin e basenit ujor;
- d) përgatit materialet për mbledhjet e këshillit të basenit ujor.
- dh) ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe këshillit të basenit ujor.

DISPOZITA KALIMTARE

1. Subjektet fizike dhe juridike, të cilat shfrytëzojnë ujërat nëntokësore pa u pajisur me leje apo autorizim, sipas dispozitave të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, *detyrohen të vetëdeklarojnë veprimtarinë e tyre pranë zyrave të administrimit të baseneve ujore, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.*
2. Subjektet që vetëdeklarojnë veprimtarinë e tyre brenda afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, *nuk ndëshkohen për kundërvajtjen administrative të kryer.*
3. Këshilli i Ministrave përcakton procedurën që do të ndiqet dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë subjektet vetëdeklaruese, *brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*
4. *Funksionet që kanë aktualisht strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore do të vazhdojnë të kryhen po nga ky institucion, deri në momentin kur buxheti përkatës i vitit 2018 t’i transferohet Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.*



Technical Secretariat of the
National Water Council

FALEMINDERIT !